



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E PENALITETEVE TË ZBATUARA NË RASTIN E TËRHEQJES SË**  
**PARAKOHSHME NGA FONDI I PENSIONIT PRIVAT**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. 142, datë 28.08.2024.*

**Neni 1**

**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e masës, mënyrës së llogaritjes dhe zbatimit të penaliteteve në rastet e tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga llogaria individuale e anëtarit në fondin e pensionit privat.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 72, pika 3, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

**Neni 3**

**Përkufizime**

1. “Aktive të tërhequra” në kuptim të kësaj rregulloreje është vlera neto e aktiveve të kërkuara për t’u tërhequr, mbi të cilat zbatohet penaliteti për tërheqjen e parakohshme nga fondi i pensionit privat.
2. Termat e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

## **Neni 4**

### **Masa e penaltetit**

1. Shoqëria administruese përcakton dhe përllogarit penaltetin e aplikuar në rastin e tërheqjes së parakohshme brenda kufijve të mëposhtëm:
  - a. Jo më pak se 2% dhe jo më shumë se 5% të aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
  - b. Jo më pak se 5% dhe jo më shumë se 10% të aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon, pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet, përfshirë edhe vitin e 20-të;
  - c. Jo më pak se 10% dhe jo më shumë se 15% të aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon, pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
  - d. Jo më pak se 15% dhe jo më shumë se 20% të aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.
2. Për efekt të llogaritjes së penaltetit të tërheqjes së parakohshme, si datë e kontributit të parë do të konsiderohet data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e pensionit dhe në rastet e transferimit të aktiveve, data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e parë të pensionit.

## **Neni 5**

### **Mënyra e llogaritjes së penaltetit**

1. Penalteti në rastin e tërheqjes së parakohshme llogaritet mbi vlerën neto të aktiveve të kërkuara për t'u tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas rastit në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat në fuqi, në momentin e tërheqjes.
2. Penalteti i aplikuar në rastin e tërheqjes së parakohshme llogaritet nga shoqëria administruese në përputhje me këtë rregullore. Llogaritja bëhet duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e anëtarësimit në fondet e pensionit privat të anëtarit, e cila fillon nga momenti i kontributit të tij të parë dhe përfundon në momentin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha aktiveve nga llogaria e tij individuale në fondin e pensionit.
3. Kur anëtari transferon aktivet në një fond tjetër pensioni privat, për efekt të llogaritjes së penalteteve në rast të tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga fondi i ri, në përllogaritjen e kohëzgjatjes së anëtarësimit do të përfshihet edhe periudha e anëtarësimit që nga data e

derdhjes së kontributit të parë në fondin e parë nga i cili janë transferuar aktivet. Në çdo rast të transferimit të aktiveve në një fond tjetër pensioni privat, anëtari informon shoqërinë administruese të fondit ku po transferohen aktivet, në lidhje me shoqërinë ku është derdhur kontributi i tij i parë. Shoqëria administruese e fondit ku janë transferuar aktivet konfirmon me shoqërinë administruese në fondin e së cilës është derdhur kontributi i parë i anëtarit, për datën e derdhjes së kontributit të parë.

4. Kur anëtari zgjedh të hapë një llogari tjetër në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri ose nga një shoqëri tjetër administruese, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rast të tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga ky fond i ri, kohëzgjatja e anëtarësit do të llogaritet që nga data e derdhjes së kontributit të parë në këtë fond të ri.

## **Neni 6**

### **Procedura e mbajtjes të penalitetit**

1. Shoqëria administruese brenda 30 ditë nga marrja e kërkesës së anëtarit, urdhëron depozitarin të kryejë pagesën e aktiveve që do të tërhiqen nga anëtari.
2. Depozitari verifikon llogaritjen e penalitetit për tërheqjen e parakohshme të kryer nga shoqëria administruese.
3. Depozitari në ditën e marrjes së urdhrit nga shoqëria administruese, kryen pagesën e aktiveve neto të kërkuar për t'u tërhequr nga anëtari. Pagesa e penalitetit do të kryhet nga depozitari sipas afatit dhe kushteve të përcaktuara nga shoqëria administruese.

## **Neni 7**

### **Përfundime nga mbajtja e penalitetit**

Nuk aplikohet penalitet për sponsorin/punëdhënësin në rastet e tërheqjes së parakohshme të punëmarrësit, brenda periudhës përpara se punëmarrësit t'i lindë e drejta për të përfituar kontributet e derdhura nga punëdhënësi në favor të tij, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vite. Përfundimi nga penalitetet është vetëm për pjesën e kontributit të derdhur të sponsorit/punëdhënësit.

## **Neni 8**

### **Detyrimi për informim**

1. Shoqëria administruese duhet të informojë anëtarin e fondit mbi penalitetet e zbatueshme dhe masën e penalitetit në rastin e tërheqjes së parakohshme, sipas parashikimeve në nenet 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, si dhe duhet t'i evidentojë qartë dhe t'i shkruajë në vend të dukshëm në kontratën dhe prospektin e fondit të pensionit privat.

2. Me marrjen e kërkesës për tërheqje të parakohshme nga ana e anëtarit të fondit të pensionit, shoqëria administruese duhet t'i shpjegojë qartë, pasojat financiare që i shkaktohen nga përfundimi i anëtarësisë dhe tërheqja e parakohshme nga fondi i pensionit privat, sipas parashikimeve në nenet 72, 73 dhe 156, të ligjit.

### **Neni 9 Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 125, datë 07.12.2010, "Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit vullnetar" shfuqizohet.

### **Neni 10 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.